



KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL V/2021

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 5 (pestë) të rregullt për vitin 2021 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 31.05.2021
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Nexhat Ramadani
Z. Bashkim Ndrecaj
Z. Brahim Curri
Z. Alban Berisha
Z. Shefket Kolgeci
Z. Xhemajl Kabashaj
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj. Shqipe Ramaj
Z. Lirim Qatani
Z. Reshat Selimaj
Z. Ardian Kotorri
Z. Bexhet Kuçi
Z. Aziz Bytyqi
Z. Gazmend Gashi
Znj. Bardha Gashi
Znj. Mirlinda Muqa

Z. Rilind Krasniqi
Z. Jeton Rrakaqi
Z. Arbërim Basha
Z. Dardan Berisha
Znj. Marigona Gashi
Znj. Florie Bytyçi
Z. Sami Hajdari
Znj. Shkëndije Zenelaj
Z. Osman Selimaj
Z. Leonard Shala
Z. Dugagjin Palushi
Znj. Laureta Tafaj
Z. Gëzim Kryeziu
Znj. Afërdita Morina

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Habibe Bytyqi
Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi dhe e prezantoi rendin e ditës:

REND DITE

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirimin nga pagesa e qirasë dhe faljen e borxhit të pa paguar;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat permes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
4. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2020,të komisionit Komunal të aksionarëve për NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A;**
5. **Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-mars 2021;**
6. **Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe i njofton me rendin e ditës.

Nexhat Ramadani – përshëndet të pranishmit.Shpreh keqardhje për situatën që është kriju në mbledhjen e fundit në Asamble.Sjellja jo e mire e kryesuesit ka qenë shkaku kryesor pse ne e kemi lëshu mbledhjen.Mendoj që Kryesuesi e ka pas obligim ta qes në votim.Ne si LDK nuk e kem kulturë lëshuarjen e institucioneve,dhe jemi sot këtu për me nxjerr vendime sa ma t’mira për intaresa të qytetarëve.

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim.

Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirimin nga pagesa e qirasë dhe faljen e borxhit të pa paguar;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Xhemajl Kabashi - përshëndet të pranishmit.Si projekt-vendim është i qëlluar.A janë vetëm këto 7 familje apo janë edhe tjera që kanë pas borgj, e kanë pagu.Nëse ka që kanë pagu dhe i lirojmë këta që s’kanë pagu ,atëherë po bëjmë dallime.Ne i mbështesim.Vetëm të kemi sjellje të barabartë për të gjithë.

Kryesuesi - sa e dime ne ,janë vetëm 7 familje.

Agim Bylykbashi - realisht janë 7 familje që kanë borgje.Para vitit 2014 të gjitha familjet janë të liruara nga pagesa. Këto borgje janë aktuale.Pra unë kam thënë që është mire ti lirojmë të gjithë nga pagesa.Ka që kanë pagu ,por jo të gjithë.Kështu që Asamblea e ka të drejtën me i liru nga pagesa këto familje që kanë pak borgje dhe ato familje që i kanë marrë tash me pagesë.

Xhemajl Kabashi - esenca ishte që me bo ni rregullore dhe me përdor ni kriterium për të gjithë.

Gëzim Kryeziu - plotësisht pajtohem që mos me pagu familjet e dëshmorëve. Mirëpo a kemi të drejtë ne si Asamble me marrë një vendim që mi liru tash dhe mos me ardh çdo vit e njejta problematikë.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat permes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën e tretë dhe e hap debatin.

Jeton Rraçaqi - ne si grup parlamentar jemi kundër sepse nuk janë respektu procedurat në raport me qytetarin.

Nexhat Ramadani - kërkoj sqarime nga drejtori i drejtorisë apo nga Kryetari. Pse janë të ndara dhe pse nuk janë analizu më herët. Pse nuk janë pru me kohë këtu? A është kërkesë e dikujt që është gurëthyes aty, apo që nuk është gurëthyes, e do me bo gurëthyes. Ne si grup parlamentar nuk do ta votojmë.

Gëzim Kryeziu - unë sa jam i informuar, zotëria në fjalë ka pas gurëthyes dhe ka heq dorë nga gurëthyesi dhe ka hap një vepromtari tjetër. Pse tash u interesu dhe për kë është tu u bo.

Rilind Krasniqi - Nexhat është dasht qysh herët kur janë mbajët seancat mos me leju. Vazhdone si e e keni nis. Keni bo dame të mëdhaja. Kryetar mbjell lule sa të duash e drunjë se e din në çfarë gjendje është.

Nexhat Ramadani - ne e kemi të drejtën tonë dhe e japim mendimin tone. Arsyeja kryesore është se kjo nuk po na bind neve.

Kryetari - ky gurthyes nuk fillon sot por ka funksionu më herët, ka 10 - 15 vjete ka edhe fabrikë që prodhon fasada. Kontrata i ka skadu mirëpo e ka licencën, por prap ju vendosni.

Kryesuesi - e hedh në votim.

9 për, 15 kundër, 2 apstenime

Nuk miratohet Pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2020, të komisionit komunal të aksionarëve për NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A;

Kryesuesi - e elaboron këtë pike dhe hap debatin.

Reshat Selimaj – përshëndet të pranishmit. Flet për raportin e punës dhe aktivitetëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve NPL "Stacioni i Autobusëve". Pasi ne jemi prekur nga koha e pandemisë dhe tre muaj nuk kemi punuar, kërkoj nga drejtorja e inspeksionit që ti angazhoj inspektorët sepse me financat po kem problem.

Bashkim Ndrecaj - Kryetari ka dhënë premtim që veq ka një mbledhje ka mu mbajt, por në raport po shkruan nga dy?

Reshat Selimaj - statusi i ndërmarrjes e lejon dhe për 2 në muaj ose 24 në vit.

Dardan Berisha - sa po funksionon bashkëpunimi ndërmjet Rilindit, Reshatit dhe Komisionit për analizimin dhe verifikimin e pronave? Autobusët që vijnë në relacionin Prishtinë - Prizren, a duhet patjetër me hy në stacion dhe sa është tarifa?

Reshat Selimaj - sa i përket bashkëpunimit kam gjet mbështetje dhe nga Bordi i Drejtorëve dhe nga anëtarët e Aksionarëve. Sa i përket autobusëve, stafi i ndërmarrjes nuk ka të drejtë jashtë vijave të stacionit të reagoj. Është drejtorja e Inspeksionit.

Dugagjin Palushi - përshëndet të pranishmit. Performanca e këtij komisioni është negative. Ndërmarrja është aset i Komunës dhe ky Komision mbron interesat e Komunës. Këta duhet me bo gjendjen faktike dhe s'ka nevojë me thirr asnjë komision. Keni mbajt 24 takime dhe asgjë s'keni bo.

Rilind Krasniqi - ndërmarrja e stacionit të autobusëve – Suharekë është një prej ndërmarrjeve më të sukseshme në Kosovë pavarësisht pengesave. Të hyrat të gjitha i ka vetanake, 97 % hyrje dalje të autobusëve dhe 3 % prej lokaleve. Problem i Stacionit të Autobusëve janë lokalet brenda stacionit. Është

mire komisioni për qështjen e pronave ta shqyrtoj edhe një here këtë rast. Nëse nuk mundeni Kryetar me i ndihmu financiarisht, është mire këto lokale me i kthi në menaxhim të ndërmarrjes. Stacioni s'ka punar 3 muaj dhe ka pas krizë.

Nexhat Ramadani - pyes antarët e komisionit sepse këtë raport nuk e kam të qartë, shihet që fitimi bruto është 90.680 ndërsa shpenzimet janë 112.000. A ka operu me afarizëm pozitiv apo negativ dhe sa është ky fitim dhe kjo humbje.

Kryesuesi - ndërmarrja nuk ka punuar tre muaj, dhe nuk ka pas të hyra. Kjo ndërmarrje rigjeneron të hyrat nga shërbimet, dhe falë dividendës që ka arrit që shumë vite, shpenzimet e veta i ka mbulu nga aty.

Shqipe Ramaj - kush janë antarët e rinjë të bordit?

Reshat Selimaj - jep përgjigje.

Dugagjin Palushi - ata tre muaj që ka qenë mbyllur, nuk i ka pengu këta me i mbajt mbledhjet.

Rilind Krasniqi - është e vërtetë që kemi mbajt mbledhje. Ka pas kërkesa për shqyrtim, dy nga lokalet që janë branda stacionit ka pas kërkesë për lirim nga qiraja.

Kryesuesi - e hedh në votim

16 për, 7 kundër, 3 apstenime
Miratohet pika 4.

Pika 5. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-mars 2021;

Kryesuesi - e elaboron këtë pike, dhe hap debatin. Nuk ka.

Pika 6. Pyetje dhe përgjigje;

Laureta Tafa - përshëndet të pranishmit. Sapo mora një mesazh nga banorët e fshatit Duhël, ku thuhet se: Kryetari ka filluar me ndërtimin e një rruge e cila nuk është në vijën buxhetore, kjo rrugë po rregullohet vetëm se Kryetari Muharremanaj është shok me dy nga banorët e asaj lagje.

Këso ankesa kemi pas pothuaj në çdo fshat. Në fshatin Sllapuzhan është i dëmtuar kanalizimi, a ka naj plan që munet mu rregullu?

Kryetari - sa i përket kanalizimit janë procedurat, por është qështje e Hidroregjionit. Ne jemi mundu në shumë fshatra mi kry punët, ku kemi pas mundësi. Sa i përket pyetjes tjetër rrugët kanë mu kry si janë në buxhet.

Laureta Tafa - përsërit mesazhin e qytetarëve të Duhlës.

Kryetari - kur të kryhen punët, del në teren i shikon a janë kry.

Bashkim Ndrecaj - përshëndet të pranishmit. Para disa seancave i kemi nda 80.000 euro me një kërkesë nga K.F. Ballkani. Dua ta di a i ka marrë Ballkani? Rruga Skënderbeu në Reshatn ngjason si mbas luftës. Djali i heroit Besim Ndreca është infermier dhe nuk jeni në gjendje me ja siguru ni vend pune, i cili ka tre here që konkuron.

Kryetari - është e vërtetë që kam kërku bartjen e të hyrave vetanake për Ballkanin. Deri para një jave nuk ka pas të hyra vetanake dhe nuk kemi pas të drejtë me i shfrytëzu. Përmend rrugët që nuk janë pastru e që nuk janë kompetencë e Komunës. Kam informatë që Ministria shumë shpejt ka me rregullu atë rrugë. Dhe pyetja tjetër, djali i Besim Ndreca është duke punu.

Bashkim Ndrecaj - unë thash për vend të përhershëm pune, dhe jo si është duke punuar me kontratë.

Jeton Rraqi - ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve thotë: të gjithë fëmijët e dëshmorëve në kushte të barabarta kanë përparësi për punsim.

Për rrugën Skënderbeu dhe të gjitha rrugët, a jeni të informuar që qytetarët i ushtrojnë padi Komunës për makinat që po i prishen nëpër gropa? Me date 5 maj 32 pacient presin për fotografim rentgen, dhe vetëm dy pacient shërbehen sepse mjeti prishet, dhe janë detyru me shku privat. Keni nda mjete për klube sportive dhe nuk jeni në gjendje të siguron insulinat. Këkesës së pronarit të lokalit në oborrin e gjimnazit iu ka përgjigj drejtorja e shkollës ku ndër tjera thotë: këshilli drejtues ka shqyrtuar kërkesën dhe

mbas kontratës me qiradhënësin tuaj ju me të drejtë e keni ndërtuar dhe po punoni,prandaj duhet ti drejtoheni atij për paqartësi.Kërkoj sqarime për këtë.

Sa lëndë janë duke u hetu në Prokurori për keqpërdorime në Komunën Suharekës?

Kryetari - janë dy lëndë që janë në hetime. Sa i përket QKMF-së barnat esenciale i blejmë me mundësi.

Jeton Rraaqi - menzi një pediatër e ke pru mbas 4 viteve.Është mire me nda fonde se ta lejon ligji.

Kryetari - bifeja është dhënë me Asamble,por kompetencë e shkollës është.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime shtesë.

Shefket Kolgeci - përshëndet të pranishmit.Unë dy tre herë kam qenë te qendra e vaksinimit ku kishte një tollovi dhe unë kam reagu në facebook ku kam kritikë qeverinë.Ato vërejtje kanë ndiku për mire dhe janë zhvendos në palestër.Në mbledhjen e ardhshme do të kërkoj një interperlancë nga drejtoresha e shëndetësisë për qështjen e menaxhimit të pandemisë.

Kryetari - ne kemi propozu te salla te gjimnazi,dhe është e vërtetë që ka pas tollovi,vaksina ka njëherë,por jo mjaftueshëm.

Shefket Kolgeci - qështja kryesore është e menaxhimit.Vaksina do të ketë mjaft.

Kryetari - nuk ka mjaft vakcina.Deri tash 2500 janë vaksinu,dhe duhet me lan rezrva për ata që e kanë kohën e caktuar për tre javë.

Jeton Rraaqi - nuk jeni përgjegjës për vakcina por ju jeni përgjegjës për krijim e kushteve aty.

Kryetari - është salla sportive në gjimnaz,por ne nuk mundemi me bo kushte pa ardh prej ministrisë me vendos sistemin aty.

Xhemajl Kabashi – te projekti i Drejtorisë së Bujqësisë për sera kam bërë një analizë dhe ia kujtoj Kryetrit që gjatë fustës ka deklaruar që Drejtoria e Bujqësisë sa kam qenë unë drejtor ,ka kriju shumë raste sociale me sera nga një ari.Ju kujtoj që edhe ju keni kriju 49 raste me sera nga një ari.

Kryetari - nuk di pse s'konkurojnë me 5 ari por ndodh edhe me gjys dojn të punojnë.

Xhemajl Kabashi - A e ndieni veten përgjegjës për një akuzë të pabazë?

Kryetari - jo,konkursi është publik,i shpallur.

Shefket Kolgeci – kanalizimi në Vraniq a do të kryhet apo do të mbetet edhe këtë vit ?Sepse prej 2017 ka fillu?

Kryetari - i kemi nda 120.000 euro për kanalizim dhe ka mu kry si është në paramasë.

Brahim Curri - përshëndet të pranishmit.Kam propozu që të bëhet ndriçimi për fshatin Grejkoc dhe fshatin Vraniq,pasi Kuvendi ka miratu këtë projekt - vendim me këto ndryshime pse s'ka fillu ende ndriçimi? Në fshatin Studenqan janë shpërnda 49 sera, ndërsa në fshatin Grejkoc vetëm një?

Enver Shabani - më vje keq por fshati juaj nuk ka fituar donacion.Premtoj që këtë vit do të kryhet ndriçimi në fshatin tuaj.

Xhevdet Gashi - jep përgjigje.

Elmaze Bytyqi - përshëndet të pranishmit.Pse nuk po funksionalizohet rentgeni i dhëmbëve kur dihet që aparatura është blerë para tre viteve? A keni informacione se nga kush kryhen shërbimet me zbardhues të dhëmbëve dhe sa participojnë pacientët? Punëtorëve shëndetësor u është ndaluar parkingu i automjeteve në oborrin e QKMF-së.Në cilin ligj është bazuar ky vendim?

Kryetari - parkingu është ndalu për shkak të qarkullimit të lire të qytetarëve.Është parkingu tjetër,një minute larg në këmbë.

Alban Berisha - para se me fillu sheshi,ju keni thënë që njëherë ka mu bo bajpasi që me dal prej Shirokës.Ku ka mbërrit ky projekt? Është për tu frigu se si do ta kalojmë flugën e komunikacionit si qytet. E keni përmend një rreth rrotullim te stacioni i policisë me u bërë,pastaj ke premtu Komunë të re.

Kryetari - në fushatë nuk kam premtu Komunë të re.Kemi bërë një marrëveshje me Ministrinë e Adminisratës dhe Pushtetit lokal në vlerë 1.5 million euro,mirëpo paret i ka hek ministria.Sipas ekspertëve nuk mund të bëhet rreth rrotullimi.Rrethi do të bëhet te shkolla Destan Bajraktari për shkak të numrit të madh të nxënësëve.Te sheshi nuk di pse ka mu bërë ai fluks kur rruga ekziston si përpara. Unazat janë projekte të mëdhaja dhe kemi probleme me shpronësimin e tokave.Punët vazhdojnë mirëpo me një dinamikë më të vogël për shkak të shkurtimeve buxhetore.

Alban Berisha - a është e vërtetë që ke thënë vet që ka mu kry bajpasi pastaj sheshi,apo se ke dit që duhet mi shpronësu pronat ?

Kryetari - është projekt i madh dhe jemi duke punuar.

Alban Berisha - u ngrit një shqetësim nga banorët në lagjen ku është hap Interex,dhe nuk ka një masë të marrë nga Interex,dhe ju Kryetar jeni përgjegjës për qytetarët për një jetë të qetë,pa zhurmë. Komisioni i performancës a kanë facebook sepse do të kishin rendit ka fillimi ?

Kryetari - për 3 - 4 vite 10 milion euro donacion kemi marrë. Te Interex, ja ka dhënë ligji dhe janë duke punu inspektorët për atë punë.

Sa i përket kanalit në Reshtan,është një marrëveshje me hidroregionin.Ata ku punojnë e prishin dhe nuk e rregullojnë.

Gëzim Kryeziu - kisha pas dëshirë me ditë emrin e ekspertit i cili paska thënë që nuk bëhet rreth rrotullimi te stacioni policorë. E ke fut rrugën në mes të lagjes dhe të gjithë banorët janë të pakënaqur.

Kryetari - në moment që fillon ndërtimi i rrugës,rruga vjen ku ka qenë,posht dhe lart nëpër qendër.

Flori Bytyqi - është e domosdoshme dhe emergjente të sigurohet insulinat.E keni ni fond emergjent dhe është mirë me prurje në Asamble.Sa i përket vaksinave na duhet një objekt që i plotëson kushtet dhe është mirë ti bëhet presion Ministrisë.Kisha kërku të lejohen parkingjet brenda oborrit të ambulantës për teknikë në ndërrimin e dytë. Mjetet që janë nda për lift te Kulla,asgjë s'është bë. Me ja bo ni ngjyrim urës,pamja do të dilte ma bukur.

Kryetari - është e vërtetë që lifti ka qenë në buxhet,por e ka hek Prishtina nga buxheti.Te vaksinimi duhet Ministria me vendos sistemin.Te parkingu duhet me bo zgjidhje për ndërrimin e dytë,dhe për Insulinat,fondi emergjent është hargju për vërshime dhe duhet me shiku një buxhet te shëndetësia.

Nexhat Ramadani - në seancën e kalume kemi diskutu për investimet kapitale dhe si gr.parlamentar kem propozu një deklaratë me disa të gjetura dhe konstatime të cilat besoj qëndrojnë.U kriju pamundësi për vazhdimin e seancës dhe nuk u vazhdua as në seancën tjetër.Për diçka që është në të mirë të qytetrëve nuk u morr ky vendim.Secili prej delegatëve keni mujt me argumentu.Çka po ndodh ?Ky shqetësim i joni prap është tu vazhdu. Pse i është ndërtu rruga e Kryetarit të Alencës në Leshan e cila nuk është në listën e investimeve kapitale,pastaj rruga te Kryezitë dhe nuk bëhen rrugë që kanë më shumë banorë e që janë në listë të investimeve kapitale. A është bë rruga Lisi i madh ? Rruga Mërgimtari,a është shtru dhe a është në projekt ?

Enver Shabani - jep përgjigje.

Nexhat Ramadani - ju i shkelni vendimet dhe paramasat janë të njejta për gjithë fshatrat.

Rilind Krasniqi - ka raste.P.sh. rruga Kosova në Studenqan është e planifikuar qe katër vite dhe nuk është shtruar.

Kryetari - unë sa e di vazhdon ,nese del te lagjja e Sallaukëve.

Dardan Berisha - sa është duke u respektuar vendimi i Ministrisë për mbajtjen e mësimit plotësues nëpër shkollat? Pse nuk ka pediatër për fëmijë nëpër qerdhet e fshatrave? Pse nuk ka shërbime stomatologjike nëpër AMF?

Kryetari - ka në disa fshatra që kryhen shërbime stomatologjike. Përderisa nuk na lejon Ministria buxhet shtesë,ne nuk mundemi me marrë norma.

Remzi Bajselmani - jep përgjigje.

Takimi përfundo : 12 :10

Procesmbajtësja :
Dafina Haziraj